

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandali 'KAYO', Hoxhaj: U dhanë 30 milionë euro nga buxheti i shtetit për makina të salduara në një ka panon
ADRESA	https://piranjat.al/politike/skandali-kayo-hoxhaj-u-dhane-30-milione-euro-nga-buxheti-i-shtetit-per--i104118
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 19:38:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 19:20:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ea3eefe25ad2108a8b7bc93ca8b6f9873fd4016757e9500196b62569fe3b6cdd
TEKSTI	8485cc4f8f27451dffae8e4d30edc2b90ff6cad030e2512db633f170827100aa
PAMJA	aab0d8f50911dc93123b9eca57fce11e35a46e44eb141c33ea712286a6ff10c2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	695326ad38f4abba570c0fd560fe2a0d5d0737362d528fb8a7019f4e1cca69cf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	49912a82e108233a2f4c1eb29c0feee4310e444550233db1ec41850f1c69f554
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/695326ad38f4abba570c0fd560fe2a0d5d0737362d528fb8a7019f4e1cca69cf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash:

asnjë letër
zyrtare,

mes Roni
Yeffet dhe
tre të huaj...

dhe
kërcënon

duke iu
drejtuar
me fjalët:

kush janë
tre

me burg për
rolin e tij si
kultivues në
një fermë

Veriut
shkaktojnë

Cardiff,
nënshkruan

lirohet,
është

prag të
seancës që
pritet të

POLITIKE

Skandali 'KAYO', Hoxhaj: U dhanë 30 milionë euro nga buxheti i shtetit për makina të salduara në një kaponon

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 21:20



Një skemë e re abuzimi me fondet e ushtrisë shqiptare ka dalë në dritë, duke zbuluar detaje tronditëse të menaxhimit të parave publike dhe përfshirjes së individëve të dyshimtë në kontrata shtetërore. Investigimet mediatike, të nisura fillimisht nga indiciet e dhëna nga ish-zëvendëskryeministri Arben Ahmetaj, kanë zbërthyer skemën se si rreth 30 milionë euro nga taksat e shqiptarëve kanë përfunduar në llogaritë e kompanisë "Timak Defense".

Sipas të dhënave të publikuara, kjo kompani është krijuar si një bashkëpunim mes kompanisë shtetërore "Kayo" dhe personave privatë. Edhe pse shteti zotëron vetëm 20% të aksioneve, ai mban të gjithë peshën e financimit. Pjesa e mbetur prej 80% kontrollohet nga aksionerë privatë, të cilët raportohet se kanë bërë një investim fillestar prej vetëm 490 eurosh për blerjen e aksioneve. Në kontrast të plotë, vetëm dy muaj pas themelimit, shteti disbursoi menjëherë 10 milionë euro, ndërsa shifra e përgjithshme e dhënë si paradhënie llogaritet të ketë arritur në 30 milionë euro.

Gazetari i Syri tv dhe emisionit Plug, Julian Hoxhaj tha në "Çim Peka Live", se faktet e zbuluara tregojnë se pavarësisht shumave marramendëse dhe propagandës për mjete të blinduara ushtarake "Made in Albania", nuk ekziston një linjë e mirëfilltë prodhimi. Mjetet thjesht modifikohen dhe saldohej në një kaponon të adaptuar, ndërkohë që shteti ka vënë në dispozicion jo vetëm paratë, por edhe ambientet e punës.

Një aspekt tjetër shqetësues i kësaj historie është heshtja dhe vonesa e institucioneve të drejtësisë, specifikuat e SPAK. Për muaj të tërë pas denoncimeve të para, nuk pati asnjë lëvizje për të filluar hetime kryesive, derisa publikimi i audio-përgjimeve të fundit i ktheu faktet në një skandal publik të pamohueshëm.

Çim Peka: Do ta filloj me Julian. Keni bërë një emision, Plug, ku jeni marrë me Roni Yeffet. Keni publikuar dokumente, keni publikuar të dhëna. Nga audio përgjimet e publikuara nga prej Arben Ahmetaj, dukeshin qartë se ata ishin të shqetësuar. Emisioni është transmetuar, dokumentet kanë qenë publike, SPAK as nuk është lodhur të marrë indiciet për të filluar hetimin, vetëm pas përgjimit kur ata nuk kanë çfarë bëjnë, po bëjnë sikur janë të interesuar për të hetuar. Por në fakt përgjimet nuk bëjnë gjë tjetër, veçse vërtetojnë ato çfarë ju keni publikuar. Ndërkohë është para një viti apo para shumë kohësh.

Julian Hoxhaj: Në muajin janar të këtij viti.

Çim Peka: Pra nga janari e deri më sot, SPAK-ut nuk i interesonte të hetonte. Edhe pse faktet ishin bërë publike. Vetëm kur u bë zhurmë apo bëhet e madhe, bën sikur është i interesuar aq sa të marrë nga Syri audio përgjimet për të hetuar Kayo-n e famshëm.

Julian Hoxhaj: Shiko, emisioni në fakt zanafillën e ka pikërisht nga emisioni i katërt ose nga intervista e katërt që ju keni zhvilluar me Arben Ahmetajn. Ka qenë po në atë intervistë ku Arben Ahmetaj ka bërë, ka dhënë indicie për veprimtarinë e Roni e Yeffet në Shqipëri, duke nisur nga ato që ishin denoncuar më përpara, që nga tentativa për t'i dhënë tokën e ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, borxhin e shtetit, përfshirjen në aeroportin e Vlorës, dhe shumë gjëra të tjera. Dhe në atë emision denoncoi apo publikoi të dhëna që lidheshin pikërisht edhe me mënyrën se si Edi Rama po përgatiste që të gjitha asetet e ushtrisë shqiptare, të gjithë paratë që vihen pra, pjesa e buxhetit që shkon për armatime, t'i shkonte pikërisht Roni e Yeffet. Ne morëm indicie, e investiguam në një farë mënyre, faktet janë publike sepse janë të dhëna, janë transaksione thesarit, janë dokumente në regjistrat e QKB-së. Sigurisht që ne kemi investiguar sepse kemi shkruar deri në Senegal, atë që Roni Yeffet e përmend në audio përgjim si vendin ku merren armët, paketohen në Shqipëri dhe më pas shiten në vende të ndryshme. Dhe Senegali ishte një pikë interesante sepse e lidhte Roni e Yeffet-in me një nga miqtë që tashmë i është dënuar kryeministrit Edi Rama, Charles McGonigal. Dhe normalisht ne kemi publikuar të dhëna në atë kohë që tregonin se sa shpejt, me atë mënyrën fap, fap, kryeministri kishte firmosur, pra si ishte themeluar kompania Timak Defense. Kompania që është në bashkëpronësi mes Kayo, pra kompanisë shtetërore, dhe Arjeta Pucës dhe Roni e Yeffet. Ku Roni dhe Arjeta Puca kanë 80% të aksioneve, ndërsa shteti ka vetëm 20%. Dhe çfarë ka ndodhur dhe këtu dua të ndalem pak ta theksoj sepse në thelb është një mini-incenerator, ose është një formë inceneratori apo një formë e të gjitha koncesioneve që Edi Rama ka dhënë nga 2014-a deri më sot. Sepse shteti është financuesi kryesor i të gjithë veprimtarisë. Ne kemi parë të dhënat e dokumenteve

Çim Peka: Juli, që të mos hyjmë në detaje, sepse për t'u thënë shqiptarëve se Rama vjedh, s'u ke thënë gjë të re. Forma dihet, ai vetëm vjedh. Forma e Ramës është vjedh, vjedh, vjedh. Do gjejmë të huaj, do gjejmë shqiptarë, në rastin konkret ka gjetur një izraelit.

Julian Hoxhaj: Dua t'i bëj një përgjigje direkt në fakt drejtorit të Kayo-s, Ardi Velit. Sepse Ardi Velit pak ditë më parë ka deklaruar në një studio televizive se Roni Yeffet u bë aksioner maxhoritar, pra me 80% të aksioneve, sepse premtoi se do të investonte shumë. Në fakt, deri më sot na rezultoi që i vetmi investim që ka bërë Roni Yeffet ka qenë 490 euro që ka blerë aksionet tek Arjeta Puca dhe investimin e ka bërë shteti. Ka disbursoi 2 muaj pasi u themelua kompania menjëherë 10 milionë euro. Dhe aktualisht që ne flasim, kjo kompani ka marrë 2.5 miliardë lekë apo rreth 30 milionë euro nga taksapaguesit shqiptarë. Pra shteti shqiptar paguan paradhënie makinat që Edi Rama i shet si "Made in Albania", por në fakt edhe në emisionin e para disa ditëve pamë që

nuk kishte asnjë linjë prodhimi, por ishin makinat, të paktën me syrin e një njeriu po themi edhe të gazetarit, por edhe një qytetari të thjeshtë e kuptojmë që ishte një kapanon ku modifikoheshin, saldoheshin dhe më pas shiteshin si prodhim shqiptar. Pra vetëm kaq ka bërë kompania.

Çim Peka: Ka dhënë 30 milionë euro deri tani?

Julian Hoxhaj: Deri tani 30 milionë euro.

Çim Peka: Dhe ku saldohen këto makinat? Te ish godina e Irfanit?

Julian Hoxhaj: Pra makinat. Ka disa asete që ka marrë. Se këtu është interesantja. Pra, kur shteti futet bashkëaksioner me një kompani, supozohet që kompania që futet aksionere jashtë, pra kompania private, duhet të vijë me një investim, që duhet të jetë ose linja e prodhimit, ose diçka tjetër. Kurse shteti i ka dhënë dhe paratë, i ka dhënë dhe ambientet.

Çim Peka: Unë realisht besoj që t'u thuash shqiptarëve që Rama vjedh dhe të mundohesh t'i bindësh është kohë e humbur. Ata e dinë. Ne thjesht do sjellim sa herë kemi mundësi prova konkrete, për t'ju thënë njerëzve që Rama është gati të habet me këdo. Për t'ju thënë njerëzve që SPAK-u është në lojë e tij sepse nuk heton. Aty i ka provat. Kjo është më shumë për ata që besonin te drejtësia e re. Rama bashkëqeveris në mënyrë kriminale me SPAK-un. I jep publikut ushqim. Çfarë i intereson Ramës? Do lirojnë njërin, do arrestojnë tjetrin. Këtë punë, i ndërroin ai. Dua të pyes vetëm pak shpejt, si u ndjeve kur dëgjove që në përgjim flitej për ty?

Julian Hoxhaj: Shiko, ndjesia fillestare sigurisht që nuk ndihesh mirë, në momentin që bëhesh objekt bisede e disa njerëzve që quhen trafikantë, ose vetëquhen. E kanë deklaruar që janë trafikantë. Dhe sigurisht që ky ishte një moment, personalisht nuk e kam përjetuar po them në nivele problematike, por janë familja, njerëz të afërt të shqetësuar, dhe as nuk do të ndal hapat e mia sepse është një çështje që duhet ndjekur, e konsideroj serioze. Sepse një nga çështjet kryesore apo problemet kryesore që u përmend edhe në audiopërgjime ishte pikërisht që Roni Yeffet thoshte që mediat do të flasin shumë për ne, do të merren shumë me ne e tjerë e tjerë. Pra fokusi i tyre do të jenë gazetarët. Sepse të vetmit që mund të nxjerrin zbuluar pikërisht punët e pista të kësaj qeverie nëpërmjet njerëzve të tillë janë gazetarët.

Çim Peka: Edhe gazetarët me gishta.

Julian Hoxhaj: Patjetër. Ata pak gazetarë, të cilët kanë guximin, kanë hapësirën sigurisht si ne në Syri Televizion, që të bëjnë punë të tilla për të denoncuar aferat e kësaj qeverie.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 14 Shtator20:48

[U godit nga policia gjatë protestës/ Qytetari i bashkohet revoltës te Kryeministria: Të rrëzojmë qeverinë](#)

Protestuesi i cili u godit me grusht gjatë shoqërimit nga policia iu bashkua revoltës para kryeministrit. Ai bëri thirrje për ba...

POLITIKE 14 Shtator20:42

[Përfundojnë fjalimet para Kryeministrit, protestuesit nisen drejt bllokut të sigurisë: Lironi çunat! Ndalojmë edhe tek Gjykata e Lartë](#)

Pas përfundimit të fjalimeve të mbajtura nga përfaqësues të shoqërisë civile, aktivistë dhe qytetarë, protesta...

POLITIKE 14 Shtator20:24

[FOTO- ‘Mos u kthe më në Shqipëri’/ Edi Rama sulmon me thonj dhe kërcënon emigrantin shqiptar në avion](#)

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

POLITIKE 14 Shtator20:12

[Dhuna policore, protestuesit me deklaratë të përbashkët: Efektivët tejkaluan kompetencat! Do të vijojmë bllokimin e institucioneve dhe Kuvendit](#)

Dhuna e pretenduar policore gjatë protestës së 107-të kundër qeverisë së Edi Ramës ka sjellë reagimin e protestuesv...

POLITIKE 14 Shtator19:31

[Rama reagon sërish për rrogat e gjyqtarëve: Vetëm qeveria ka të drejtë për pagat](#)

Kryeministri Edi Rama ka reaguar sërish lidhur me pagat e gjyqtarëve. Përmes një postimi në rrjetet sociale, kreu i qeverisë e ka ...

POLITIKE 14 Shtator19:22

[Nesër seanca për Veliajn në Gjykatën e Lartë, Bardhi: Nëse lirohet, është funerali i Reformës në Drejtësi](#)

Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, ka reaguar në prag të seancës që pritet të zhvillohet nes&e...

POLITIKE 14 Shtator18:56

[107 ditë revoltë! Nis mbledhja e qytetarëve në sheshin “Skënderbej”, kërkohet dorëheqja e Edi Ramës](#)

Sot shënohet dita e 107 e protestës qytetare. Ka nisur mbledhja e qytetarëve në sheshin “Skënderbej” nga ku protestuesit m&...

POLITIKE 14 Shtator18:51

[Trafiku i armëve, Kalaja: Fakti që Shqipëria është një vend anëtar i NATO-s, e bën këtë skandal akoma më të rëndë](#)

Një skandal i përmasave ndërkombëtare duket se po mbahet i fshehur në sirtarët e Ministrisë së Mbrojtjes. Për m&eum...

POLITIKE 14 Shtator18:48

[“Belinda po qeveris. Ku është SPAK?”, Aulon Kalaja: Duhet t’i japë përgjigje çështjes Balluku](#)

Aulon Kalaja u ndal te çështja e Belinda Ballukut, duke thënë se SPAK duhet t’i japë përgjigje kësaj çësh...

POLITIKE 14 Shtator18:45

[“Kemi dhe ‘Timak China’, Çollaku: Karrigen në NATO, qeveria paradite e mban vetë, pasdite ua jep kinezëve](#)

Gazetari Basir Çollaku, i ftuar në emisionin ‘Task Force’ me Sonila Meçon në SYRI TV, ka hedhur akuza të forta lidhur m...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 13 Shtator

[Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dy...](#)

Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

POLITIKE 14 Shtator

[FOTO- ‘Mos u kthe më në Shqipëri’/ Edi Rama sul...](#)

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

AKTUALITET 13 Shtator

[E rëndë në Patos, një person gjendet i pa jetë ...](#)


Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak më parë në Patos.Një person është gjetur i pa jetë në oborrin e bane...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranajat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...


video



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV





Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.